



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

<b>Numri i Çështjes</b>	71041-01062-11-2018	<b>Data e Regjistrimit</b>	5/2/2018
<b>Numri i Vendimit</b>	11-2018-3225	<b>Data e Vendimit</b>	7/3/2018

**VENDIM**  
**NE EMER TE REPUBLIKËS**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:**

**KRYESUES:**           Petraq Çuri  
**ANËTAR**               Joana Qeleshi  
                              Rexhep Bekteshi  
  
**SEKRETARE**         Eriola Gashi

**Objekti:**             Heqjen e sekuestros se sendeve sipas procesverbalit te dt.14.10.2016.  
**Baza Ligjore :**     Neni 219 e vijues i Kodit te Procedures Penale - Disponime ne mos kthimi.

**Përmbledhja e vendimit:**

Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi çështjen dhe pasiadministroi provat dhe aktet e ndodhura në dosje, në seancë gjyqësore;

Dëgjoji palën kërkuese që kërkoi pranimin ekërkesës;

Prokurorin Drini Pali që kërkoi pranimin ekërkesës;

Vëren:

Kërkuesi i dënuari\*\*\*\*\* \*\*\*\*\* , ka paraqitur kërkesë para kësaj gjykate, më datë 30.04.2018, meobjekt:

Heqjene sekuestros së sendeve sipas procesverbalit dt.13.10.2016 dhe 14.10.2016.

Konstatohet se çështjaështë në juridiksionin gjyqësor dhe kompetente për gjykimin e saj është Gjykatae Rrethit Gjyqësor Durrës.

***Nga shqyrtimi i çështjes rezultoi se:***

Gjykata e RrethitGjyqësor Durrës, me vendimin nr.530 datë 25.07.2017, lidhur me këtë të pandehur, ka vendosur:

*"1-Deklarimin fajtor të tëpandehurit \*\*\*\*\* \*\*\*\*\* për kryerjene veprës penale të "Kultivimit të bimëve narkotike të parashikuar nga neni284/2 i K.Penal dhe konformë kësaj dispozite dënimit e tij me 6 (gjashtë) vjetburgim.*

*2-Në bazë të nenit 406/1 tëKPP uljen e dënimit me 1/3 duke e dënuar përfundimisht me 4 (katër) vjetburgim.*

*Ky dënim do t'i filloj nga data e arrestimit 14.10.2016 dhe do të vuhet në njëburg të sigurisë së zakonshme.*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

.....”

Ky vendim ka marrë formë të prerë me vendimin nr.157 datë 20.03.2018 të\*\*\*\*\* së Apelit Durrës.

Në kërkesën e tij kërkuesi, tanimë i dënuar dhe duke vuajtur dënimin pranë I EVP Fushë Krujë, pretendon se me “Procesverbalin e sekuestrimit të sendeve” datë 14.10.2016 të Prokuroprisë, i janë sekuestruar “Një telefon i markës Blackberry, me ngjyrë të zezë, me nr.IMEI 355419058368039, menumër telefoni të kompanisë Eagle me nr.0666126605.

*Një telefon i markës IPHONE6, me numër IMEI 354443060712308, me numër telefoni 0665437636 me cod pinCLS320”.*

Gjithashtu nga ana e organit të akuzës me “Procesverbalin e sekuestrimit të sendeve” datë 13.10.2016, i janë sekuestruar një shumë prej 3.349.000 lekë dhe 149 dollarë USA.

Në kërkesat e tij përfundimtare në gjykimin e çështjes së themelit nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, nuk janë përmendur këtoprocesverbale, mbasi ligjërish ato duhet të përcaktoheshin se kujt duhet t’iktheheshin, konformë nenit 190 të KPrP, përcaktimin e provave materiale të çështjes.

Kërkuesi pretendon se shuma prej 3.349.000 lekë, nuk vjen nga veprimtarikriminale por ato janë të babait të tij shtetasit \*\*\*\*\* , mbasi në bazëtë kontratës së shitblerjes nr.533 repdhe nr.259 kol datë 09.01.2015, \*\*\*\*\* e Lumturie \*\*\*\*\* kanë shitur një sipërfaqe toke prej 7670m2 palëes blerëse Fushë Kruja Cement Factory shpk, në shumën prej 5.000.000 lekë, e cila do të paguhej deri në fund të muajit dhjetor 2015.

Nga ana e prokurorit u paraqitën procesverbalet e pretenduara prej palëskërkuese, si dhe u parashtrua se nga ana e tij nuk është disponuar lidhur me këto sende në gjykimin e çështjes në themel, dhe për rrjedhojë sipas tij palakërkuese ka të drejtë në pretendimet e saj.

**Gjykata mbasi dëgjoi palët, arrin në përfundimin se kërkesa e palës kërkuese \*\*\*\*\* është e drejtë ligjërishte duhet të pranohet.**

1.Neni 190 i KPrP shprehet:

**“Disponimipër provat materiale.**

1. Nëvendimin përfundimtar ose në atë të pushimit të çështjes, gjykata ose prokuroricaktojnë se çfarë duhet bërë me provat materiale duke urdhëruar:

a) sendetqë kanë shërbyer ose ishin caktuar si mjet për kryerjen e veprës penale dhesendet që përbëjnë përfitimin e nxjerrë nga ajo ose shpërblimin e dhënë a tëpremtuar për kryerjen e saj, merren dhe i kalojnë shtetit, **përveç rastit kur këto sende janë të personave që nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale;**

b) sendet, mbajtja ose qarkullimi i të cilave është i ndaluar, u dorëzohen entevpërkatëse ose zhduken;

c) sendet që nuk kanë asnjë vlerë zhduken;

ç) sendet e tjera ukthehen personave që u takojnë dhe, kur ka konflikt për pronësinë e tyre, ruhengjersa ai të zgjidhet nga gjykata.

2. Provat materiale mund t’u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

*procedimit, kurnuk dëmtohet zgjidhja e çështjes”.*

2.Nisur nga kjo përmbajtje e kësaj dispozite, duke qënë se prokuroriparashtroi se këto sende nuk vijnë nga vepra penale e kryer prej kërkuesit\*\*\*\*\* , por vlerësohet se janë të prindërve të tij, gjykata vlerëson sekopnformë dispozitës së mësipërme, shuma prej 3.349.000 lekë e cila ndodhet e depozituar pranë Raiffeisen Bank dhe shuma prej 149 dollarë e cila ndodhet e depozituar pranë Intesa SanPaolo Bank, t'i kthehen kërkuesit.

3.Gjykata bazuar në nenin 217 të KPrP,pika 3, sipas të cilit:

*“Kthimi i sendeve tësekuestuara.*

1.....

*3.Pasi vendimi merr formë tëprerë, sendet e sekuestuara i kthehen atij që i takojnë,përveç rasteve kurvendoset konfiskimi.”*

4.Gjykata vlerëson se nga provat e paraqitura prej kërkuesit sendet ekonkretisht shuma e lekëve dhe aparatet celularë, duhet t'i kthehen atij, përshkak se nuk kanë lidhje me veprën penale të kryer dhe se ato i përkasinprindërve të tij.

5.Gjykata vlerëson se në rastin konkretvendimi ka marrë formë të prerë dhe lidhur me sendet prova materiale, siprokurori dhe gjykata nuk janë shprehur, duke e lënë çështjen të pazgjidhurlidhur me këto prova. Prandaj zgjidhja e pretendimeve të palës kërkuese ështëdetyrim për gjykatën për të përcaktuar fillimisht përkatësinë e tyre dhe dukeqënë se u vërtetua se ato i përkasin personave të tjerë të familjes, duhet qët'i kthehen atyre.

Kjogjykatë vlerëson se kërkesa e kërkuesit \*\*\*\*\* , duhet të pranohet.

**Për keto arsye:**

Baza Ligjore:Gjykata pasi pa dhe nenet 217,190 të KPrP;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

Vendosi:

Pranimin e kërkesës së kërkuarit \*\*\*\*\* , të datës 30.04.2018.

Heqjen e sekuestros sipas procesverbalit të datës 13.10.2016, kthimin e shumës prej 3.349.000 lekë, e cila ndodhet e depozituar pranë Raiffeisen Bank (derdhur me faturën dt.07.12.2016 nga Artur Leka) dhe shuma prej 149 dollarë e cila ndodhet e depozituar pranë Intesa SanPaolo Bank,(me faturën dt.07.12.2016 nga Artur Leka), kërkuarit \*\*\*\*\* .

Heqjen e sekuestros sipas procesverbalit datë 14.10.2016, kthimin e sendeve “Një telefon i markës Blackberry, me ngjyrë të zezë, me nr.IMEI 355419058368039, me numër telefoni të kompanisë Eagle me nr.0666126605. Një telefon i markës IPHONE 6, me numër IMEI 354443060712308, me numër telefoni 0665437636 me cod pin CLS320”, kërkuarit \*\*\*\*\* .

Ky vendim të bashkohet me vendimin nr.530 datë 25.07.2017 të \*\*\*\*\* së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke u bërë pjesë e tij.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të shtetasit \*\*\*\*\* .

Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës, nga e nesërmja e shpalljes.

Durrës, më 26.06.2018

Ky dokument është marrë nga [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al). Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.